

KNF - Kalim në Digjital në BP - TEB Kosovë

Lokacioni:	KOSOVË
ID e Projektit:	56755
Sektori industrial:	Institucione financiare
Lloji i njoftimit:	PRIVAT
Kategoria Mjedisore:	FI
Data e aprovimit:	18 gusht 2026
Statusi:	Në eksplorim, në shqyrtim përfundimtar
Data e shpalosjes në anglisht:	17 gusht 2026

Sipas seksionit 1.4.2 (iii) të Direktivës për Qasjen në Informacion: “Për projektet e miratuara nga menaxhmenti i Bankës ku Bordi i Drejtorëve ka deleguar autoritetin për aprovim, DPP do të shpaloset në fillim të periudhës përkatëse të njoftimit për asnjë kundërshtim për një vend anëtar të Bankës në përputhje me nenin 13 (iii) të Marrëveshjes për Themelimin e BERZH-it.”

Përshkrimi i Projektit:

Një hua senior e pasiguruar deri në 5 milionë euro për TEB Sh.A. (TEB) në kuadër të Programit të BERZH-it për Kalim në Digjital në Ballkanin Perëndimor (Go Digital) për kreditim të mëtutjeshëm për ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM) të pranueshme në Kosovë.

Objektivat e Projektit

Të ardhurat e investimit të Bankës do të përdoren për sigurimin e një kombinimi të financimit të specializuar për automatizim, digjitalizim, konkurrueshmëri dhe teknologji të gjelbra për NVM të pranueshme në përputhje me Deklaratën e Politikës përkatëse. Të paktën 60 për qind e investimeve të përgjithshme duhet të jenë në projekte të pranueshme për automatizim dhe digjitalizim, nga të cilat të paktën 60 për qind të duhet të jenë të pranueshme për GET. Për më tepër, të paktën 60 për qind e investimeve të përgjithshme duhet të jenë të pranueshme për GET.

Ndikimi i Tranzicionit

Poentimi ETI: 65

Projekti kontribuon në objektivat për Kalim në Digjital, duke mbështetur cilësitë e Ndikimit të Tranzicionit si **Konkurrues** dhe **I gjelbër**:

Konkurrues: Projekti do të inkurajojë konkurrueshmërinë e NVM-ve duke zgjeruar huadhënien digjitale për NVM-të në përputhje me standardet e KNF-së.

I gjelbër: Projekti do të kontribuojë në cilësinë e gjelbër të NT-së duke adresuar eficiencën e energjisë si pjesë e aktiviteteve të pranueshme të investimeve të NVM-ve.

Informata për Klientin

TEB SH.A.

TEB Sh.A. u themelua në vitin 2007 si degë e TEB Holding, një ndërmarrje e përbashkët 50-50 ndërmjet BNP Paribas (BNPP) dhe Colakoglu Group. Sipas të dhënave nga fundi i vitit 2025, TEB është banka e pestë më e madhe komerciale në Kosovë, duke mbajtur një pjesë tregu prej afërsisht 10.8 për qind sipas gjithsej aseteve dhe 12 për qind sipas neto kredive, me fokus strategjik në kreditimin e shitjeve me pakicë dhe NVM-ve.

Përmbledhja e Financimit të BERZH-it

5,000,000.00 EURO

Gjithsej Kosto të Projektit

5,000,000.00 EURO

Shtueshmëria

Shtueshmëria në këtë projekt përfshin sigurimin e financimit afatgjatë dhe afatmesëm të padisponueshëm në tregun afatshkurtër të financuar nga depozitat, së bashku me ekspertizën për automatizim, digjitalizimin dhe huadhënie të gjelbër.

Bashkëpunimi teknik do ta ngrejë kapacitetin e brendshëm të TEB-it për të përmirësuar përpjekjet për digjitalizim dhe kursim të energjisë, duke siguruar pajtueshmërinë me kërkesat mjedisore dhe sociale (MS), ndërsa 60 për qind e nën-huave pritet t'i plotësojnë standardet e GET.

Një komponent gjinor SMART promovon qasje me ekuitet në financa për NVM-të e drejtuara prej grave, me trajnim të specializuar për të përmirësuar gatishmërinë për digjitalizim, atraktivitetin e projektit dhe strategjitë për kontaktim me përgjegjshmëri gjinore.

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

I kategorizuar FI (ESP 2014). TEB Sh.A. është klient i ri i BERZH-it. Nënprojektet e pranueshme do të mbështesin huadhënien për NMVM-të sipas disa linjave kreditore me përdorimin e të ardhurave të drejtuara për gratë në biznes dhe huadhënien e gjelbër, të cilat ka gjasa të jenë me risk të ulët mjedisor dhe social. Risqet kryesore Mjedisore dhe Sociale lidhen me aftësinë e klientit për ta zbatuar SMMS-në e vet, çështjet e punësimit dhe të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë, si dhe ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale. Kujdesi i duhur Mjedisor dhe Social është ndërmarrë përmes një shqyrtimi të pyetësorit për MS të plotësuar nga klienti dhe komunikimit përcjellës me klientin.

KDMS-ja ka identifikuar hendejë në pajtueshmëri, të cilët do të adresohen përmes veprimeve të dakorduara me klientin dhe të reflektuara në një Plan për Menaxhim Mjedisor dhe Social (PMMS).

Nga Klienti pritet ta zhvillojë SMMS-në e vet që t'i vlerësojë, menaxhojë dhe monitorojë në mënyrë efektive risqet dhe ndikimet MS në përputhje me Kërkesat Mjedisore dhe Sociale (KMS) 2, 4 dhe 9 të BERZH-it sipas Politikës Mjedisore dhe Sociale (PMS). Këtu përfshihet pajtueshmëria me Listën e BERZH-it për Përrjashtimet për MS dhe përputhshmëria me udhëzimet relevante të BERZH-it për institucionet financiare. Nën-huamarrësit e financuar nga klienti duhet të jenë në pajtueshmëri me ligjet nacionale në fuqi për mjedisin, çështjet shëndetësore, të sigurisë dhe të punës. TEB-i do t'i dorëzojë BERZH-it raporte vjetore për MS, duke detajuar zbatimin e vet të SMMS-së, pajtueshmërinë me kërkesat e BERZH-it, rezultatet e shqyrtimit të nënprojekteve dhe çdo incident material MS.

Prej TEB-it kërkohet edhe të shpalosë publikisht informacionin për SMMS-në e vet sipas PMS-së të vitit 2024.

Vlerësimet e Gjelbra

Projekti përcaktohet si i përafruar me Marrëveshjen e Parisit bazuar në aplikimin e qasjes së BERZH-it për përafrim me Marrëveshjen e Parisit për investimet e financuara në mënyrë të tërthortë. Përcaktimi i përafrimit bazohet në aplikimin e shtyllës 1 (përkushtimi i palës homologe ndaj Marrëveshjes së Parisit) dhe shtyllës 2 (filtri për nën-transaksionet). 60 për qind e financimit të BERZH-it klasifikohet si financim i gjelbër, pasi që mbështet aktivitetet për arritjen e objektivave të zbutjes së ndryshimeve klimatike.

Bashkëpunimi Teknik dhe Financimi me Grante

BT-ja përfshin mbështetje për NVM-të nga Konsulenti i Programit për përgatitjen e planeve të investimeve relevante dhe të kreditueshme nga banka, si dhe për mbështetjen e institucioneve financiare partnere për zhvillimin e një linje të projekteve dhe portfolio të nën-investimeve të pranueshme, duke ndihmuar në zbatimin, monitorimin dhe verifikimin e zbatimit teknik dhe pajtueshmërisë së investimeve para se të lëshohet pagesa stimuluese për NVM-të relevante. Gjinia është integruar në nivel të programit për të përfshirë një fokus specifik në NVM-të e drejtuara prej grave, me trajnime për të rritur konkurrueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e operacioneve të biznesit të përfituesve fundorë.

Bashkëpunimi jo-Teknik përfshin deri në 0.5 milion euro për stimuj investimi për nën-huamarrësit për zbatimin e investimeve për automatizim dhe digjitalizim në përputhje me kriteret e pranueshmërisë të specifikuara në Deklaratën e Politikës së Programit.

Informatat e Kontaktit të Kompanisë

Taulant Besimi

Taulant.Besimi@teb-kos.com

+383 38 230 000

www.teb-kos.com

Preoc nr. 56, Graçanicë 10500, Kosovë

Përditësimi i fundit i DPP-së

17 gusht 2026

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i

përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikat e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime për praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke [përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH.

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose

PUBLIC
për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime
mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.